



Pranuar / Dorezuar Priljezen / Predato Received / Delivered	08 - 02	1	viti year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa e Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOK	559 / 2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.411/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.411/2020 të datës 11.12.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë Rr. "Kadri Zeka", Kati 1, Nr.14, në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.prot:05-7566 të datës 13.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.411/2020 e datës 11.12.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]**
- II. Ndryshohet Vendimi me Nr.prot:05-7566 i datës 13.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit.**
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] Inspektor Shëndetësor pran Inspektoratit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 11.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3090/2020 te

regjistruar me numër A.nr.411/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.prot: 05-7566 të datës 13.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen e shkallës së pagës për periudhën dy (2) vjet".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 16.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Shëndetësisë. Këshilli më datë 24.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 11.12.2020 me numër protokolli 3090/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:05-7566 të datës 13.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën për përfshirjen në Pakon Emergjente Fiskale e datës 14.08.2020; Informatë e datës 21.10.2020; Kërkesë për inicim të Komisionit Disiplinor e datës 19.10.2020; Shkresën e fundit për të me njoftuar me vendim të mëhershëm nuk me ka kthyer e-mail nuk është përgjigjur e datës 23.11.2020 nga ankuesi; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 12.11.2020; Akt Emërimit e datës 01.11.2017; E-mailin e datës 29.10.2020 nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 26.10.2020 nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 08.10.2019 nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 08.10.2019 nga ankuesi për [redacted] E-mailin e datës 08.10.2029 nga [redacted] për ankuesin; E-mail i datës 19.10.2020 nga [redacted] për [redacted] E-mail i datës 19.10.2020 nga [redacted] për [redacted], E-mail i datës 10.11.2020 nga [redacted] për ankuesin; Formulari për njoftimin e shkelësit të supozuar për veprimin disiplinor i datës 10.11.2020; Procesverbali i takimit të komisionit disiplinor lidhur me intervistimin e dëshmitarëve dhe shkelësve të supozuar ndaj të cilëve është iniciuar procedurë disiplinore i datës 12.11.2020 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 24.12.2020; Vendimin me Nr. 204/IX/2020 i datës 07.09.2020; Vendimin me Nr:237/X/2020 i datës 27.10.2020; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 29.03.2019; Akt Emërimi Nr-151 i datës 29.09.2014; Vendimi me Nr.143/VII/2020 i datës 16.07.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 13/11/2020; Diplomë e datës 12.12.2011 nga Fakulteti i Mjekësisë; Diplomë e datës 10.06.2011 nga Kolegji Dardania; Diplomë e datës 04.02.2009 nga Fakulteti i Mjekësisë; Kërkesë për prova shtesë e datës 18.01.2021 dhe dërgimi i provave shtesë datë 18.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Me datë 19.10.2020, [redacted] Ushtruese e detyrës se Kryeinspektorit Shëndetësor pran Ministrisë së Shëndetësisë, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, [redacted] nën dyshimin e bazuar se ankuesi me datë 19.10.2020 ka bërë shkelje të rëndë të obligimeve dhe përgjegjësi të punës, për shkak të ndërhyrjes dhe shantazhit ndaj Ministrit të Shëndetësisë në Kabinetin e Ministrit.

Komisioni Disiplinor pran Ministrisë së Shëndetësisë bazuar në kërkesën e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 12.11.2020 ka mbajtur seancë dëgjimore dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe dëgjimit të dëshmitarëve ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij, me vetëdije, pa lejen e eprorit, pa ftesë dhe pa caktuar termin ka penguar në punë Ministrin e Shëndetësisë, stafin e kabinetit të ministrit dhe stafin civil në përgjithësi dhe është prononcuar në media pa autorizim dhe pa përfillur procedurat ligjore, me ç'rast ka tejkaluar veprimet e lejuara etike, morale dhe ligjore, duke kryer shkelje të lehta disiplinore bazuar në nenin 46 paragrafi 4 nen paragrafi 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike. Me tutje Komisioni Disiplinor bazuar në dosjen personale të ankuesit ka konstatuar se ankuesi me datë 08.10.2019 ka të shqiptuar masë disiplinore të natyrës së njëjtë, dhe mbi këtë bazë duke iu referuar nenit 46 paragrafi 3 nen paragrafi 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike, sjelljen e ankuesit e ka klasifikuar si shkelje të rëndë disiplinore, dhe si rrjedhojë Komisioni Disiplinor duke u bazuar në nenin 47 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike, përmes Vendimit me Nr.prot:05-7566 të datës 13.11.2020 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy (2) vjet".

Kundër Vendimit me Nr.prot:05-7566 të datës 13.11.2020 të Komisionit Disiplinor, ankuesi me datë 11.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për arsye të: Zbatimit të gabuar të dispozitave juridike, gjegjësisht shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale; si dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se stafi i Inspektoratit Shëndetësor, përfshirë edhe ankuesin, më datë 14.08.2020 kanë parashtruar kërkesë me numër protokollit 05-5139 tek Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, për përfshirjen e tyre në pakon emergjente fiskale, ndërsa me datë 19.10.2020 inspektorët shëndetësorë kanë mbajtur takim në Zyrën e Ushtrueses së detyrës të Kryeinspektorit Shëndetësor, dhe pastaj kanë shkuar në Ministrinë e Shëndetësisë për të bërë përsëri kërkesë, ku në objekt të Ministrisë kanë takuar Ministrin e Shëndetësisë, dhe nga i njëjti kanë kërkuar që t'i pres në takim për të biseduar rreth kërkesës së tyre për përfshirje në pako emergjente fiskale. Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke u bazuar në deklaratën e dëshmitarëve, respektivisht deklaratën e Ushtrueses së detyrës të Kryeinspektorit Shëndetësor dhe deklaratën e dëshmitarit B.V Inspektor Shëndetësor ka konstatuar se Ushtruesja e detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor ka kërkuar nga inspektorët shëndetësor të mos shkojnë të ministri sepse lidhur me çështjen e përfshirjes në pakon emergjente fiskale ka biseduar paraprakisht me ministrin.

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor ka vetëtuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike sa i përket çështjes së ankuesit pa lejen e eprorit, pa ftesë dhe pa caktuar termin ka penguar në punë Ministrin e Shëndetësisë, stafin e kabinetit të ministrit dhe stafin civil në përgjithësi dhe është prononcuar në media pa autorizim dhe pa përfillur procedurat ligjore. Kolegji po ashtu vlerëson se Komisioni Disiplinor ka vepruar drejtë kur ka cilësuar veprimet e ankuesit si shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nen paragrafi 4.2, 4.3, dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publike, mirëpo vlerëson se gabimisht është zbatuar e drejta materiale me rastin e shqiptimit të masës disiplinore sipas nenit 47 paragrafi 1

nen paragrafi 1.3 të këtij ligji, sepse Kolegji ka gjetur se masa disiplinore "vërejtje" e datës 08.10.2019 e cila është marr si rrethanë renduese me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka qenë e shqiptuar nga organi kompetent siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, dhe si e tillë sipas nenit 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk do të duhej të prodhonte pasoja juridike.

Kështu që duke u bazuar në konstatimet se ankuesi ka kryer shkelje të lehta disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave sipas autorizimit ligjor të përcaktuar me nenin 18 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndryshon masën disiplinore për ankuesin nga masa "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën dy (2) vjet, me masën disiplinore "Vërejtje" e paraparë me nenin 47 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, dhe si rrjedhojë obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që të ndërmarr veprimet e duhura procedurale për vendosjen e masës së shqiptuar nga Kolegji, në dosjen personale të ankuesit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.411/2020

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.